



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 3458 Prot

Shkodër, më 20.10.2025

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për një vend të lirë pune, për kategorinë staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamenti i Arteve, në pozicionin lektor/e me kohë të plotë, për vitin akademik 2025 – 2026, për leksionet dhe seminarët e lëndëve "Menaxhim dizajni", "Teori e perceptimit dhe didaktikë arti" dhe "Menaxhim arti".

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :

1. Të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën e arteve pamore, në sistemin me kohë të plotë. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse, e noterizuar.
2. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 6 (Bachelor/Program studimi i nivelit të parë), duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë) ndërsa nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurrohet duhet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë). Kandidati që konkurron duhet ta ketë dhënë domosdoshmërisht provim lëndën për të cilën pretendon të jetë mësimdhënës ose lëndë të përafërta në grupin e lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurohet.
3. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 7 (Master i Shkencave, Master i arteve/Master i arteve të bukura, Program studimi i integruar i ciklit të dytë, Program studimi 4-vjeçar) duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë) dhe nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurrohet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë).
4. T'i përkasin kategorisë "Lektor", konform përcaktimit të pikës 4 të nenit 59 të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH".
5. Të njohë një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, me nivel jo më të ulët se B2 (notë jo më të ulët se tetë) të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
6. Të kenë përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë.
7. Të kenë botime.
8. Preferohen kandidatët që kanë :
 - gradën "Doktor shkencash" në fushën e arteve pamore,
 - aktivitet artistik-shkencor.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.

Sheshi 2 Prilli, Shkodër, <http://www.unishk.edu.al>, info@unishk.edu.al

3. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.
5. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor.
7. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH "L.Gurakuqi".
8. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre) me punonjës ekzistues brenda të njëjtes njësi bazë/drejtorisë ku kërkojnë të punësohen si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Të aplikojë "on-line" në faqen zyrtare të USH në internet në adresën www.unishk.edu.al (rubrika Njoftime për punësim- pedagog të brëndshëm)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse.
4. Kopje e noterizuar e dëshmime të kualifikimeve pasuniversitare dhe gradës shkencore "Doktor" dhe/ose titujve shkencorë (nëse ka të tilla).
5. Tre rekomandime nga të cilat të paktën dy prej mësimdhënësit me tituj shkencorë në profilin për të cilin konkurren dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.
6. Kopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose kopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshop etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penalteti + vërtetim gjykate + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përmbartimit).
10. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë).
11. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon (kopje e noterizuar e librezës së punës nëse ka) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 5 të rregullores së posaçme të Universitetit "Për punësimin në USH" (për mos-lidhje farefisnore dhe/ose konflikt interesi).
13. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.
14. Vërtetim rajoni për adresën/rezidencën e banimit (kontratë qiramarrje).

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat të pacaktuar.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik. (me shënimin "Për konkursin e Departamentit të Arteve")
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë brenda tri javëve nga publikimi i njoftimit, sipas orarit që do të përcaktojnë njësia baze përkatëse.
- Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, t'i drejtoheni dekanatit përkatës dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore në Rektorat.

Prof. dr. Tonin GJURAJ